REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
632, 648, 674, 691, 700/20
Nr/Br.
Data/Datum. 02-10.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit 22.09.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 02.10.2020*	Nr. i lëndës: *632-648-674-691-700/20*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.09.2020,OE "I.T.K"Shpk-Pejë,datë 09.09.2020,grupi OE"Dorearti"Shpk;"Beni com"Shpk ; "Lindi Markings" Shpk-Pejë,datë 17.09.2020,OE "Select Prima"Shpk-Prishtinë,datë 17.09.2020 grupi OE "TSR"Shpk &"IDK Konstruksion & 2T" (ish Sinjal RKS-Shpk)-Prishtine dhe datë 21.09.2020 OE "RSM Company"Shpk -Prishtinë kanë parashtruar ankesë me nr: 632-648-674-691-700/20, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, "Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës Lot 2" me nr.të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Infrastrukturës".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:Kontratë Publike,**Punë**,vlera e parashikuar e kontratës: **2,200.000.00 €.**

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka pasur disa vendime të OSHP-së,PSH.nr.321-332/18 të datës 17.08.2018; PSH.nr.455-464/18 të datës 05.10.2018; PSH.nr.181-182-191/19 të datës 19.06.2019; PSH.nr.463-467/19 të datës 06.09.2019; PSH.nr.906-907-922-925-926/19 të datës 30.01.2020; PSH.nr.148-165-168-172-179/20 të datës 29.05.2020,me të cilët është rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "I.T.K" SHPK –PEJË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së

Kompania jone pretendon se eshte shkele LPP I ndryshuar dhe plotesuar me Lgjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,Neni 7 Barazia J0 Diskriminimi, Neni 59

Ekzaminimi,Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve dhe Neni 60 Kriteret per nhenten e Kontrates Neni 62 Perfundimi i Aktivitetit te Prokurimit

Me date 15.11.2019 jemi njoftuar permes email adreses se kornpanise jone permes letres standarde per tenderit e pasuksesshem jemi njoftuar se na nuk na eshte dhene kontrata per LOT 2, per te cilin konsiderojme qe na eshte bere e pa drejte duke u thirrr ne ligjet dhe nenet e cekura me larte pasi qe kompania jone edhe ne kete LOT 2 sipas proceverbalit te hapjes se tendereve ka ofruar qmimin me te ulet sipas kerkeses se dosjes se tenderit dhe i ploteson te gjitha kerkesat tjera qe kerkohen ne dosje te tenderit.
Me daten 18.11.2019 kompania jone ka dorezuar Kerkese per Qasje ne dokumente per sa i perket LOT 2 per te cilen me daten 18.11.2019 ora: 11:31 kemi pranuar permes emailit vendimin e AK ku na eshte mundesuar qasja ne dokumente ne diten e njejt prej ores 15:00.
Gjate verifkimit te dokumentacionit te prezantuar nga OE i rekomanduar per Kontrate kemi verejtur qe ISO: 39001 eshte e skaduar ne vitin 2018 (nuk kishte asnje dokument shtese qe deshmon vazhdimin e saj)
Shkelqim Ibrahimi i caktuar si Ing i mungonin kontrata e punes,referencat etj.

Sinjal RKSshpk nuk kishte te prezantuar Raportet e Auditimit siq kerkohet ne FOT por vetem te antareve te tjere te konzorciumit te cilet jane 2 kompani nga Shqiperia.
Mungonet Lista e Paisjeve e noterizuar,kompania Sinjal RKSshpk kishte prezantuar nje kontrate Huazimi me nje kompani nga Gjermania (Krasniqi GmbH) e cila nuk eshte e noterizuar dhe le hapesire per dyshime.
Mbeshtetja Financiare apo qasja ne Kredi mungonet, si deshmi financiare ishin vetem disa gjendje bankare te Raiffeisen Bank per periudhen 01.01.2016 deri me 15.08.2017 ku shuma ne llogari ishte vetem rreth 273 Euro nje gje e tille deshmon qe kompania ne fjale nuk ka kapacitet financiare apo qasje ne kredi ne ndonje nga bankat e licencuara qe operon ne Kosove siq kerkohet ne FOT.
Kompania jone ITK sh.p.k. duke u bazuar ne dosjen e tenderit me saktesisht tek pjesa e sasive te peraferta te planifikuara te cekura ne Speficikacionet Teknike te Oosjes se Tenderit del qe oferta e ofruar nga Operatori Ekonomik I rekomanduar per Kontrate SINJAL RKS& 2T SHPK dhe IOK Konstruksion SH.P.K. eshte me I shtrejte per 197,844.48 Euro duke I shkaktuar demtim te Buxhetit te Kosoves per vleren e cekur me larte, ku kjo vlere per 3 vite sa parashihet kontrata i ben dem buxhetit te kosoves per shu men prej 593,533.45. Ku e njejta llogari eshte pothuajse e ngjajshme edhe per lot 3.
Andaj duke u bazuar ne keto kalkulime gje per te cilen deshmohet lehtesisht nga kjo mund te konkludojme qe kompania jone ITK sh.p.k. eshte Operator Ekonomik I Pergjegjeshem si dhe I ploteson kushtet per dhenien e kontrates per LOT 2 per shkak se eshte me C;mim me I ulet se Operatoret Ekonomik te rekomanduar per dhenie te kontrates.

Ne baze te ketvre fakteve ne kerkojm nga Autoriteti Kontraktues-Ministria e Infrastruktures te rishqyrtoj vendimin e saj per dhenien e Kontrates per LOT 2 dhe te na vleresoje si fitues kontrate per LOTIN 2 kompanine tone ITK sh.p.k.
Me datesn 18.11.2019 kompania jone ka parashtruar kerkese per Rishqyrtim te vendimit te AK per dhenie te kontrates per OE i rekomanduar per kontrate te dates 15.11.2019.

Me daten 21.11.2019 AK ka bere Anulimin e Tenderit deri ne rishqyrtim te ankesave te pranuara nga OE.

Me daten 27.11.2019 AK ka aprovuar Kerkesen per Rishqyrtim te dorezuar nga kompania jone.

Me daten 29.11.2019 AK ka njoftuar qe bere Anulimin e Tenderit si dhe njeherit na eshte derguar Letra Standarde per Tenderuesin e Eleminuar e cila ne baze te fakteve dhe dokumenteve te dorezuar ne kete tender nuk qendron pasi qe kompania jone ITK shpk eshte OE i pergjegjshem si dhe ofron qmimin me te lire per LOT 2.

Me daten 30.01.2020 OSHP ka detyruar AK qe tenderin ta rikthej prap ne Rivleresim dhe AK ka filluar procedurat e Rivleresimit duke kerkuar vazhdimin e Sigurimit te Tenderit dhe Validitetit te ofertes me daten 10.02.2020 te ellen ne si kompani i jemi pergjigjur meniher duke i derguar dokumentet e nevojshme.

Me daten 25.02.2020 kemi marre Letren Standarde per Tenderuesin e Eleminuar si dhe njoftimin e dates 25.02.2020 per Anulim te Tenderit.
Me daten 31.08.2020 kemi pranuar kerkese per Vazhdim te Validitetit dhe Sigurimit te tenderit, ku brenda dites eshte kerkuar qe te dergohet Sigurimi dhe Validiteti i ofertes, dhe po ne te njejten dite pas dergimit te ketyre dokumentave AK pak para perfundimit te orarit te punes e bene publikimin e vendimit per Anulim te tenderit dhe dergon letren standarde per tenderuesin e eleminuar,ku konsiderojme qe eshte bere shkelje per shkak se ne kete tender ka OE te pergjegjshem dhe me qmime me te lire andaj nuk duhet te anulohet tenderi,por OE i cili i ploteson kushtet dhe kriteret e para para me FTO te shpallet fitues ne kete rast kompania jone ITK shpk te shpallet fitues i LOT 2 per shkak se edhe me qmim eshte me i lire por edhe i plotesone te gjitha kushtet dhe kriteret e para para.

Me daten 02.09.2020 kemi bere kerkese per rishqyrtim te vendimit te AK per anulim te tenderit duke marre parasysh se ka OE te pergjegjshem dhe me qmime me te lira,ku ne si OE I plotesojme te gjitha kushtet dhe kriteret e para para me FDT,por me daten 03.09.2020 kemi pranuar vendimin nga AK ku na eshte refuzuar kerkesa nga ana e AK.

Poashtu konsiderojme qe Anulimi i Kesaj procedure te Prokurimit bie ndesh me vendimet e marruar me heret nga OSHP per lenden e njejt siq jane:
Vendimi i OSHP nr 440,450,452,460/17 te dates 22.01.2018

Vendimi i OSHP nr 321/18 332/18 te dates 17.08.2018

Urdheresa e OSHP 445/18 464/18 e dates 05.10.2018

Vendimi e OSHP 906/907/922/925/926-19 e dates 30.01.2020

Duke u bazuar ne keto fakte mendojme qe anulimi i teresishem i procedures tenderuese nuk eshte vendim i drejt dhe si i tille bie ndesh me LLPdhe duhet te anulohet per shkak se per LOT 2 kompania jone ka ofruar qmimin me te lire si dhe i ploteson te gjitha kushtet e kerkuara ne Njoftimin per Kontrate dhe Dosjen e Tenderit te vendosur nga AK per LOT 2.
Andaj kerkojme nga OSHP qe te beje Rishqyrtimin e vendimit per Anulim te Aktivitetit te Prokurimit si

dhe tenderi te kthehet ne Rivleresim dhe kompania jone ITK sh.p.k. te shpallet fitues i LOT 2 per shkak se eshte OE i cili i ploteson te gjitha kushtet e kerkuara si dhe ofron qmimin me te lire siq kerkohet ne FDT.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "DOREARTI"SHPK;"BENI COM"SHPK;"LINDI MARKINGS"SHPK-PEJË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 44 i RRUOPP-së

Konstatimi i AK nuk qendron sepse ne kemi prezentuar referenca mbi vlerën e kërkuar në dosje të tenderit të cilën e kemi AK –Ministria e Infrastruktures –zyra e prokurimit na ka njoftuar me date 08-04-2019 se ne si koncercium N.P DOREARTI-BENI COM SHPK-NT LINDI MARKINGS jemi te pa pergjegjshem,sipas arsyeve te cekura ne letren standarde per tenderuesin e eleminuar.
Konstatimi i komisionit per eleminimin tone nuk qendron per shume arsye sepse kjo lende se paku kater here ishte shqyrtuar ne OSHP dhe per kete kemi vendime nga ky organ,po ju ceku vendimin me nr.321,332/18 datë 17.08.2018 dhe se fundi edhe URDHRESEN nr.455/18,464/18,datë 05.10.2018 nga ky organ per mos zbatimin e vendimeve te mehershme te OSHP-së.
Ne kemi deshmuar ne te gjitha senacat e OSHP-se si dhe vet AK ne tri raste na ka shpallur te pergjegjshem sic vertetohet me vendimet e AK te dates 30.08.2018 pas vendimit të OSHP-së per rivleresim AK ka kerkuar sqarime lidhur me kete pike ku ne si Konzercium ju kemi ofruar deshmi te mjaftueshme dhe është plotësuar ne teresi edhe kjo kerkese nga ana jone(perveq letres se perkrahjes nga banka sipas kerkeses se AK per sqarime te nenit 72 ju kemi ofruar deshmi edhe se ne posedojme edhe mjete te gatshme ne vlere prej 100,000.00 Euro sipas kerkeses tuaj dhe sipas kerkesave te njoftimit per kontrate dhe dosjes se tenderit) te cilen e deshmon edhe vendimi juaj (AK) i dates 30.08.2018 ku thuhet ne nje paragraf se ne jemi te pergjegjshem por me qmim me te larte se atehere fituesi i rekomanduar per kontrate.
Per keto dy pika te cilat na ka eleminuar AK janë vertetuar në shum seanca dhe vendime te OSHP-së por edhe vete vendimet e AK ku 2-3 raste na ka shpallur te pergjegjshem.
Per anulimin e ketij aktiviteti ne fjale siq parashihet ne nenet e lartecekura si vijon:Perfundimi i aktivitetit te prokurimit lot -3: Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:3.1 një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
4.Autoriteti kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 te gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo2.2 para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Duke analizuar te cekurat me larte sipas vendimit te fundit te OSHP-se (deri me tani kemi mbi 8 vendime te OSHP) AK vepron ne kundershtim me dispozitat e LPP dhe vet vendimin e OSHP si instanca e dyte e ankeses dhe qe per te njejtat arsye te cilat OSHP i ka gjykuar ne vendimin e fundit si te paqendrueshme dhe ne kundershtim me LPP,pra AK e anulon prap AP dhe quditerisht me arsyetiimin e njejte.
Po ju informoj se ky AP eshte prej vitit 2017 vazhdon te trajtohet atehere ne parashtrojme pyetjen se qfar rendesie paska ky AP kur nuk realizohet qe tri vite kur tani edhe 2-3 muaj skadojne kontratat tjera te nenshkruara me te njejtin AP per lote tjera me te njejten dosje ndersa ne rastin tone kinse dosja qenka gabim pas me shume se tri vite anulohet bile per pretendimet e njejta qe jane trajtuar nga OSHP(nje sqarim siq thame me larte **me te njejten dosje AK ka nenshkruar 6 lote ndersa ne ndonjehere na ka eleminuar,**ndonjehere na ka shpallur te pergjegjshem e tani nuk e di se qka do te thone kush e di qka do te zbulojne,sikur te kishin thene ne fillim te vleresimit te pare se duhet te anulohet meqe ka kinse gabime disi mund edhe vleresohej,mirepo kane nenshkruar 6 lote,dhe LPP e thote qarte se anulimi per pretendimet e AK do te duhej te behej 3 dite para hapjes e jo si ne rastin tone kur ju shterren te gjitha prallat edhe pas 8 vendimeve te OSHP e gjejn nje aryse jo te qendrueshme dhe e cila edhe eshte gjykuar ne te gjitha vendimet e OSHP-se ndersa AK prap edhe pse pretendimet e tyre jane te gjykuara nga vendimi i fundit i OSHP me te njejtat pretendime e anulon AP po ashtu po me kete dosje te tenderit AK ka shpallur fitues edhe ne kete lot-lotin 3 per te cilin ne po ankohemi por vetem kur jane bind se neve nuk munden te na kalojne shpikin pretendime te paqendrueshme vetem e vetem ta anulojne) dhe kemi vendim meritor atehere kontratat tjera te nenshkruara po me te njejten dosje a jane te ligjshme dhe si eshte e mundur te realizohen.

Pra qellimi i AK po verehet qarte është që vetem e vetem konzorciumi jone mos te shpallet fitues dhe ketu kerkojme edhe nga Ministri dhe institucionet tjera brenda ministrise te marrin veprime ligjore dhe te kemi nje vendim meritor Dhe njekohesisht te merren masa ndaj zyrtares se prokurimit te Ministrise e cila me qellim nuk e zbaton LPP dhe vendimet e OSHP-se.

Gjithashtu ju sqarojme se AK vetem per faktin qe konzorciumi ne fjale ehste e vetmja oferte e pergjegjshme per kete Lot (lot-3) ne kete AP,si duket konzorciumi ne fjale vetem per shkak te emertimit tone ose nuk ka qene i pershtatshem dhe e pranueshme per AK-në Ministria e Infrastruktures.
Ne qofte se nuk jemi te pershtatshem edhe per kete qeverisje te tanishme na tregoni dhe te kerkojm te shperngulemi nga ky vend ku ligji nuk respektohet por respektohet Kanuni i Partive Poltike.
Eshte shume shqetesuese se AK ka shperblyer me kontrat per kete Lot Operatorin Ekonomik:Select Prima dy her radhazi dhe e kemi fituar lenden ne OSHP 2 here rradhazi si te bazuar e gjeni ne vendimet e lartecekura dhe AK-apet shkel LPP.
OE i radhes i shperblyer me kontrat ka qene:Arbotek Malsija dhe ndaj keti OE kemi fituar lenden ne OSHP si te bazuar e gjeni ne vendimet e larte cekura dhe AK-apet e shkel LPP

Eshte shume shqetesuese se AK me daten 15.11.2019,pa asnje kriter rekomandon per fitues Grupin e OE Sinjal RKS SH.P.K & I.D KONSTRUKSION SH.P.K Tiranë &2T Sh.p.k Tiranë,dhe pas Kerkeses per Rishqyrtim –Ankeses te argumentuar nga Grupi i Operatoreve Ekonomik, N.P DOREARTI-BENI COM SH.P.K-N.T LINDI MARKINGS,AK e kthen ne rivlersim kete AP, dhe pa asnje baze ligjore e Anulon,vetem per faktin se Grupi i Operatoreve Ekonomik te lartepermendur është i pa pranueshem si emertim nga ana e AK-së.
Pas shume makinacioneve AK e shkel dhe nuk e respekton as Vendimin e OSHP-se nr 148/165/168/172/179/20 i dates 29.05.2020 dhe me te njejtat arsye te cilat ishin gjykuar ne vendimet e meparshme te SOHP-se prap kunderligjshem ben anulimin e AP.

Ak e ka mbajt leneden ne rivleresim per 90 dite ndersa AK e ka pas obligim te rivlersoj per 15 dite kalendarike edhe pse ne rastet e vlersimit sipas LPPse është e obliguar te bej vlersesimin brenda 30 dite plus ne raste komplekse mundet te zgjat vlersimi edhe 20 dite para gjithsejt 50 dite ndersa ky AK ne qdo rivlersim e vonon lenden mbi 90 dite duke mos respektuar afatet e LPP-se nuk e kuptojme kete veprim te AK kur per te njejtat arsye te gjykuara nga OSHP e anulon perseri duke mos respektuar asnje dispozite ligjore dhe asnje vendim te OSHP-se dhe askush nuk merr masa ndaj zyrtareve te cilet bejne shkelje te vazhdueshme duke na diskriminuar gjso here.

Po ashtu sqarojme edhe njehere se ne plotesojme te gjitha kriteret e vendosura se ne Njoftimin per Kontrat dhe Dosje te Tenderit te vendosura nga AK per Lot 3,eshte shkelur 7 sepse AK nuk na ka trajtuar ne menyre te barabarte,nenin 59 sepse nuk eshte bere vlerseimi konform ketij neni,dhe nenet 62 te LPP-se dhe neni 44 i RRUOPP-se te vertetuara nga vendimi i fundit i OSHP-se.

NESE NUK ZBATOHEN VENDIMET E CEKURA ME LARTE NE PERKUNDER DESHIRES TONE DO TI DREJTOHEMI TE GJITHA INSTITUCIONEVE LIGJORE(Agjencise Kunder Korrupsionit,Departamentit te Krimeve Ekonomike te Policise se Kosoves,Prokurorise se Shtetit dhe te gjitha institucioneve tjera kompetente per keto raste) PER SHKELJE TE VAZHDUESHME DHE TE QELLIMSHMETE AK NGA VITI 2017 DERI ME KETE DATE KUR PO JU DREJTOHEMI JUVE ME KETE AP.

Kerkoj qe te Anulohet vendimi i AK mbi Anulimin e pa ligjshem te AP-se dhe Lenda te Kthehet ne Ri-vleresim si dhe grupi i Operatoreve Ekonomik ,DOREARTI sh.p.k-BENI COM SH.P.K-LINDI MARKINGS sh.p.k te shpallet fitues ne lot 3 per faktin se i ploteson te gjitha kerkesat e vendosura nga AK ne njoftimin per Kontrat dhe FDT dhe te vertetuar ne shume raste nga vendimet e OSHP-se dhe vet vendimet e AK ne shume raste na ka shpallur te pergjegjshem por kinse ne kemi pas qmime me te larta dhe ne fund krejt kur ju shtjeren te gjitha mundesite per te na eleminuar gjen arsye te paargumentuara per te anuluar kete AP pas 3 viteve procedure te paperecedent qe vetem MI din te veproj edhe pse po kjo ministri me te njejten procedure dhe me te njejten dosje te tenderit per gjashte lotet tjera ka shpallur fitues kjo deshmon se ketu kemi te bejme me njerz plotesisht te padijshem ose me tendenca te hapura per te demtuar konzorciumin tone.
Kerkojm që te Anukohet Vendimi i AK mbi Anulimin e pa ligjshem te AP-se dhe Lenda te Kthehet ne Ri-vleresim si dhe kerkojme nga OSHP te urdheroj AK sipas LPP Grupi i Operatoreve Ekonomik, DOREARTI sh.p.k-BENI COM SH.P.K-LINDI MARKINGS sh.p.k te shpallet fitues ne Lot 3.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "SELECT PRIMA"ŠHPK - PRISHTINË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 44.7 i RRUOPP

Të nderuar ne me dt.31.08.2020 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku na ka shpallur si tenderues të eliminuar, ndërsa e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se: *"Të gjitha ofertat janë të*

papërgjegjshme".

Ju sqarojmë se ne me dt.03.09.2020 konform nenit 10 pika 3 të ligjit për Prokurim Publik, kemi **kërkuar qasje të menjëhershme në dokumentacionin e ofertës së OE ITK** në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht kemi kërkuar që të hapet kopja e ofertës së OE ITK, për shkak se kemi dyshime në ndërhyrje në dokumentacion, si dhe kemi kërkuar që të bëjmë krahasimin e ofertës origjinale me kopjen e dorëzuar.
Po ashtu kemi kërkuar të dijmë se cilët operator ekonomik e kanë ofruar zgjatjen e validitetit të ofertave, mirëpo nuk kemi pranuar asnjë njoftim nga AK-ja për lejimin e qasjes ashtu siç kemi kërkuar, ndërsa me këtë veprim AK-ja i ka shkelur dispozitat e neni 10 të LPP-së.

Arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është e pa bazuar për arsyet si në vijim:

Lidhur me arsyen e AK-së për eliminimin tonë e ku AK-ja pretendon që duhet hequr numri 1 cent në këtë llogaritje dhe të japim sqarime shtesë për numrin 00, ne ashtu siç e kemi sqaruar në sqarimin tonë me rastin e kërkesës që AK-ja e kishte bërë në lidhje me çmimin e ofruar nga ne, ne i kemi sqaruar AK-së, mirëpo po ju sqarojmë edhe juve se ne nuk kemi ofruar çmim prej 00 cent por kemi ofruar çmim prej 0.001 cent.
Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik konkretisht neni 18.3 e parasheh që "*çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës*". Ndërsa referimi i AK-së në nenin 41.15 tek Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik nuk është i saktë dhe nuk ka të bëjë me rastet siç është ky rast, por ka të bëjë me rastet kur ofertohet me çmim zero. Në këtë rast ka të bëjë vetëm neni 18.3 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP). Andaj ky pretendim i AK-së është i pa bazuar dhe i pa mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore.

AK-ja tek njoftimi mbi vendimin e AK-së e ka cekur që ky aktivitet i prokurimit është shpallur me dt.01.08.2017, ndërsa e ka shkruar se janë bërë ndryshime tek njoftimi për kontratë me dt.21.08.2017, 31.08.2017, 04.09.2017, 07.09.2017, 11.04.2018 dhe se në dosje nuk i ka bërë këto ndryshime.
Ju rikujtojmë se që nga atëherë kanë kaluar mbi dy vite që është duke u zhvilluar ky aktivitet i prokurimit dhe tani autoriteti kontraktues e ka kuptuar që formulimet në dosje të tenderit qenkan jo në rregull, se janë kërkuar nga dy herë kërkesat dhe se fillimisht nuk ka qenë e parashikuar sasia indikative e më pastaj me korrigjime të dosjes është shtuar sasia indikative etj.

Ne nuk e dimë se për çfarë shkelje po flitet në këtë rast! Shkelje pas hapjes së tenderit në aktivitete të prokurimit mund të ndodhin vetëm me qëllim nga ana e AK-së, e nëse AK-ja i ka bërë me qëllim këto shkelje vetëm për të ardhur deri te anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit atëherë duhet të japin përgjegjësi personat të cilat i kanë bërë këto shkelje, edhe pse këto shkelje nuk mund të merren parasysh në vlerësimin e tenderëve sepse autoritetet kontraktuese janë të obliguara të bëjnë vlerësimin e ofertave sipas kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ashtu siç kanë qenë të vendosura në dosje të tenderit para datës së fundit të dorëzimit të ofertave.

Edhe ky fakt tregon, tendencën e zyrtarëve përgjegjës të prokurimit për të stërzgjatur këtë procedurë e cila i shkon në favor vetëm kompanive që janë duke punuar në kontratat aktuale përkatësisht kompanive ITK dhe RSM Company.

Këto veprime po bëhen me qëllim, pasi që edhe AK-ja e din mirë se të dy operatorët ekonomik ITK dhe RSM Company janë të papërgjegjshëm dhe se nuk mund të shpallen fitues, mirëpo qëllimi i AK-së tingëllon që këta operator të pajisen me referenca përkatëse në kontratat aktuale dhe të krijojnë një avantazh në krahasim me kompanitë tjera që nuk kanë nënshkruar kontrata, e në këtë rast jemi diskriminuar ne si kompani Select Prima Shpk.

AK-ja në vlerësimin e tenderëve që nga fillimi e ka bërë duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj edhe tani në këtë vlerësim është dashur të bazohet në ato kërkesa që kanë qenë në fillim në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, sepse kërkesat e përcaktuara që në fillim nuk mund të ndryshohen pas fazës së dorëzimit të ofertave dhe hapjes së tyre.
Faktin se AK-ja e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-së dhe nenit 44.5 të RRUOPP e ka konstatuar edhe OSHP-ja me vendimin nr. nr.148, 165, 168, 172, 179/20 të dt. 29.05.2020, kur AK-ja e kishte anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsye të pabazuar në ligj.
AK-ja nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së nr.148, 165, 168, 172, 179/20 të dt. 29.05.2020, sepse siç e din edhe AK-ja, OSHP-ja me këtë vendim ka vendosur që të anulohet njoftimi për anulimin e këtij aktiviteti dhe lënda të kthehet ne rivlerësim. Gjithashtu në vendimin e lartpërmendur shihet qartë edhe konstatimi i panelit shqyrtues ku thotë se AK-ja me rastin e anulimit të këtij aktiviteti te prokurimit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Të nderuar, ju rikujtojmë se AK-ja me këto kërkesa dhe me këtë dosje dhe me të gjitha korrigjimet ka nënshkruar kontratë me operatorin ekonomik "ITK" dhe "RSM Company" duke i favorizuar ekstremisht edhe pa i plotësuar të gjitha kushtet, ndërsa tani pas kalimit të një periudhe dyvjeçare me plot parregullsi, favorizime, diskriminime të bëra ndaj operatorëve ekonomik AK-ja ka vendosur dhe po bën përpjekje që të mbyll këtë kapitull, po ashtu në mënyrë favorizuese për kompanitë të cilat kanë kontrata me AK e që janë rekomanduar në mënyrë të kundërligjshme, ndërsa në të njëjtën kohë të na diskriminojnë neve si operator ekonomik dhe operatorët ekonomik tjerë të cilët kanë qenë pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit.

AK-ja në letrën standarde për tenderues të eliminuar të cilat ju ka dërguar të gjithëve shkruan dhe flet për ndryshime të bëra edhe me dt.04.09.2019, 07.09.2019 tek njoftimi për kontratë, ndërsa ne nuk jemi në dijeni për këto ndryshime dhe AK-ja nuk ka të drejtë të ndryshoj njoftimin për kontratë e as dosjen e tenderit pas datës së ofertimit, mirëpo ne nuk e dimë se mbi çfarë baze AK-ja i ka bërë këto ndryshime.

Të nderuar, ne sa kemi njohuri si pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit, AK-ja me të gjitha këto ndryshime ka nënshkruar kontratë për lote tjera, prandaj edhe në këtë rast është dashur të veproj njëjtë dhe në mënyrë të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së dhe të rekomandoj për kontratë operatorët ekonomik të përgjegjshëm, sikurse që ka vepruar me operatorë ekonomik tjerë. Për më tepër nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në lidhje me njoftimin për kontratë që është publikuar në fillim, prandaj kundër njoftimit për kontratë sipas nenit 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së lejohet që të parashtrohet kërkesë për rishqyrtim pesë ditë para datës së fundit për dorëzim të ofertave. Duke u bazuar në këto fakte nuk ka asnjë mundësi ligjore të anulohet aktiviteti i prokurimit me këto arsye në këtë fazë.

Ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin të OE **"ITK"** se nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në lidhje me mesataren e të punësuarave në tri vitet e fundit ku është kërkuar të jetë

min. 10 të punësuar dhe kërkesën në lidhje me dëshmitë mbi pronësinë apo të marrjes me qira të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave, ku është kërkuar të sillen dëshmi në lidhje me pajisjet që do ti angazhoj në këtë projekt.

Gjithashtu ne pajtohemi me arsyet e AKsë për eliminimin e OE **"RSM Company"**, se nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit për llot II dhe III, ku janë kërkuar dëshmi mbi pronësinë apo të marrjes me qira të mjeteve , stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave, ku është kërkuar të sillen dëshmi në lidhje me pajisjet që do ti angazhoj në këtë projekt. Dhe ku është kërkuar stafi kryesor teknik, ku si dëshmi janë kërkuar Kopjet e diplomave përkatëse, CV, kontratat e punës me ofertuesin dhe referencat për stafin që do të jetë i angazhuar në këtë projekt.

Për të dy këta operator ekonomik ne kishim ngritur pretendime ankimore që nga fillimi i procesit kryesisht në këto pika që AK-ja i ka eliminuar sepse të dy janë të papërgjegjshëm, mirëpo AK-ja nuk i kishite marrur parasysh pretendimet tona ankimore, ndërsa tani pas mbi 2 viteve e gjysmë që kanë kaluar AK-ja ka ardhur në përfundim se këta dy OE janë të papërgjegjshëm për pikat që ne i kemi kontestuar.

AK-ja në vlerësimet e mëparshme e ka rekomanduar për kontratë në tri lote OE **"ITK"** i cili ka qenë i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar listën e punëtorëve për vitet 2014-2016, sepse i njëjti nuk ka ofruar raport fare për vitin 2014 dhe dëshmi nga ATK-ja dhe kështu nuk e ka arritur mesataren e punëtorëve prej 30 punëtorëve të kërkuar. Gjithashtu i njëjti operator ekonomik kishte ofruar diploma bachelor për stafin profesional ku është kërkuar inxhinier.

I njëjti operator ekonomik nuk e ka plotësuar edhe kërkesën në lidhje me makineritë sepse realisht me ato makineri që i ka në posedim ka mundur të nënshkruaj kontratë vetëm për një lot. Gjatë qasjes në dokumentacion që kemi pasur në ofertën e OE "ITK", shihet se ky OE ka pasur dëshmi vetëm për një pajisje –Makinë për shlyerjen e vijave, 2 makina për hapjen e gropave i ka prezantuar, kombi bus transportues i ka prezentuar 2, ndërsa i njëjti është shpallur fitues në tri Lote edhe pse nuk ka ofruar dëshmi për makineri për tri Lote, prandaj ky OE me këto dëshmi të makinerisë nuk ka mundur të shpallet fitues më shumë se një Lot, edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat tjera të FDT-së.

I njëjti OE është dashur të eliminohej qysh në start, pra në fillim të këtij aktiviteti të prokurimit dhe jo ti krijohej hapësirë nga ana e AK-së mbi dy vite që të bëjë ankesa të pabaza edhe pse vetë ka qenë palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit konform 111 paragrafai 1.5-1.8 të LPP-së, përkitazi me nenin 4.1.26 të LPP-së.

OE RSM Company- është i papërgjegjshëm sepse punëtoret i ka pasur të angazhuar në me shumë vende-projekte në atë kohë, si p.sh në tenderin me titull "Hyrja në qytetin e Prishtinës, ndërsa këtë fakt e ka përmendur edhe vetë përfaqësuesi i AK-së në një seancë në OSHP. Provë Vendimi i OSHP-së Nr.411/17 i dt.07.12.2017. Ndërsa kërkesë e AK-së ka qenë që të jepet një deklaratë nën betim se nuk i ka të angazhuar punëtorët në projekte tjera.
Po ashtu i njëjti OE punëtoret i ka pasur të angazhuar edhe në projektin "Ndërtimi i rrugës nacionale N2 Nadakovc-Smrekovnicë Lot 2" Me nr. prok:205-17-2995-511, iniciuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe

mendojmë që i ka pasur edhe në projektin " Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës, prandaj është dashur të eliminohet nga konkurrenca qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit dhe jo të pritet mbi dy vite.

I njëjti OE nuk ka ofruar dëshmi-vërtetim nga banka për mbështetje financiare ashtu siç është kërkuar, mirëpo i njëjti ka ofruar një dëshmi nga banka ku thuhet se do të shqyrtohet mundësia e mbështetjes së këtij operatori ekonomik dhe do ti lejohet qasje në kredi nëse i plotëson kushtet që parasheh banka.

Tek kërkesat mbi mundësitë teknike profesionale është kërkuar që të dëshmohet pronësia e pajisjeve apo të marrjes me qira të mjeteve apo pajisjeve teknike, e noterizuar ose origjinal, OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisje), që ka ndërmend ti angazhojë për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen)nga noteri sipas procedurës së verifikimit të pajisjeve), ndërsa në vërtetimin e noterit është cekur se noteri e vërteton dokumentin e përpiluar nga OE i cili quhet pajisje teknike për Lot 2 e jo pajisje (siç është kërkuar) njëjtë ka vepruar në lot 3. Prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohej qysh në fillim, pra në vlerësimin e parë e jo të trajtohej disa herë i përgjegjshëm ky operator ekonomik dhe jo ti krijohej hapësirë mbi dy vite që të bëjë ankesa të pabaza edhe pse vetë ka qenë palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 111 paragrafi 1.5-1.8 të LPP-së përkitazi me nenin 4.1.26 të LPP-së.

Siç e dini edhe ju vetë, edhe ne si operator ekonomik jemi shpall fitues, mirëpo AK-ja përsëri i ka anuluar vendimet e saj, e në disa raste vetë menaxheri i prokurimit e ka anuluar dhe nuk e ka aprovuar raportin e komisionit vlerësues duke na dëmtuar neve në këtë proces të stërzgjatur, e ku stërzgjatja e këtij procesi është bërë pikërisht nga veprimet apo mosveprimet e AK-së, ndërsa në këtë rast kemi pësuar dëme ne si kompani serioze dhe me traditë të kësaj lamie, madje duke na humbur mbi dy vite e që ne mos të arrijmë të kemi ndonjë kontratë dhe faktikisht të pësojmë dëme të pariparueshme që të mos kemi referenca të kësaj natyre tri viteve të fundit.
Edhe ky anulim i këtij aktiviteti të prokurimit me këto arsye është në vazhdën e veprimeve të kundërligjshme të institucionit të AK-së dhe në vazhdën e favorizimit të kompanive që kanë nënshkruar kontratë në këtë aktivitet të prokurimit për Lotet përkatëse dhe në të njëjtën kohë ky veprim i AK-së është në drejtim të dëmtimit të kompanisë tonë dhe reputacionit pozitiv të kompanisë tonë, prandaj edhe në këtë rast AK-ja ka vepruar në mënyrë kundërligjore duke e anuluar këtë aktivitet të prokurimit.

Të nderuar AK-ja këtë aktivitet të prokurimit e ka anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik sepse asnjëri nga kushtet e parashikuar në këto dispozita nuk janë përmbushur.

Ne me dt. 10.09.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.
AK-ja në arsyen e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim e ka cekur arsyen e njëjtë sikurse në njoftimin mbi vendimin e AK-së, duke treguar qartë se nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore, mirëpo edhe pse AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore, ne ju sqarojmë përsëri se ne nuk kemi ofruar çmim prej 00 cent por kemi ofruar çmim prej 0.001 cent. Ndërsa faktin se lejohet të ofertohet kështu siç kemi ofertuar ne e parashohin edhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik konkretisht neni 18.3 e ku thotë "*çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Çdo numër i*

shënuar pas numrit të dyte (2) nuk merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës". Ndërsa referimi i AK-së në nenin 41.15 tek Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik është i pasaktë dhe nuk ka të bëjë fare me rastet siç është ky rast, por ka të bëjë me rastet kur ofertohet me çmim zero.

Po ashtu AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare faktet tona në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit duke u munduar ti fsheh të gjitha shkeljet të cilat kanë ndodhur prej fillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e që po vazhdojnë të ndodhin edhe tani.

Përfundimisht ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet që i kemi cekur më lartë, rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sepse asnjëra nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur për anulim në këtë fazë.

Autoriteti kontraktues nuk e ka pasur parasysh nenin 1 të LPP-së dhe njëkohësisht na keni diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"SELECT PRIMA" SH.P.K**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "TSR"SHPK(ISH SINJAL SHPK) -PRISHTINË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

1. AK shkelë edhe nenin 1 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!
2. AK shkelë edhe nenin 6 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!
3. AK shkelë edhe nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!
4. AK shkelë edhe nenin 38 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!
5. AK shkelë edhe nenin 56 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!
6. AK shkelë edhe nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!
7. AK shkelë edhe nenin 62 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!
8. AK shkelë edhe nenin 44 të RRUOPP-së.
9. AK shkelë edhe D01 dhe deklaraten nen Betim

10. AK shkelë edhe nenin 108/A të LPP-së Nr. 04/L-042 i amandamentuar!

Pretendimi 1:AK ne rastin ton ka shkel Nenin 1pika 2 te LPP-se i cili thot, citojm:Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Andaj AK duke na eliminuar pa arsy dhe pa fakte dhe duke na etiketuar faktet e operatorve te tjer (Faktet kinse ne nuk kemi referenca) me te vetmin qellim qe te na eliminoj. Qe kjo nuk qendron ne kemi bashkangjitur dokumentin Deshmija 1(listen komplet nga fillojn referencat dhe ku perfundojn), e cila gjendet ne oferten e dorezuar nga ne AK, e ne te cilat jan te gjitha deshmit qe gjenden ne dosjen e tenderit qe kemi dorzu ne si konzorcium. Keto deshmi fillojn me referencat, ku fillon nga faqja 961 e vazhdon deri ne faqen 1070 te dosjes tone, te cilen ne e kemi dorzuar. Njehkosisht fletet e dosjes tone te dorezuar kan qen te numeruara, ku AK mbas kerkeses per rishqyrtimm ku ne ju kemi drejtu me fakte dhe deshmi ka pas shum leht qe ti verifikoj keto deshmi, dhe fare me e leht ka qen qe te vrehet deshmija ku vetem me kete deshmi/referenc ne kemi shumen 5 fish me te madhe se kerkesa qe ka qene ne 5/8 dosjen tenderike. Andaj AK duke mos marr mundin qe te shqyrtoj fare kto deshmi ben diskriminim dhe shkelje te keti neni. Dhe ketu lind pytja, se pse AK kerkon deshmi kur si përfill kerkesat e veta. Po ashtu AK ben shkelje te keti ligji duke mos perfill urdheresat e OSHP dhe duke anashkaluar ne kete rast vendimet dhe kerkesat e OSHP-së lidhur me kete procedure te aktivitetit te prokurimit.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 6 të LPP të amandamentuar me rastin e anulimit të tenderit. Ne ket rast AK duke u mundu qe patjeter ta anuloj kete tender edhe perkunder vendimeve te OSHP-se, e i cili tender zgjat qe 3 vite, bene shkelje te keti neni pasi qe AK me vet fakti qe ket tender e zgjat 3 vite, atehere nuk merr ne konsiderat qellimin dhe lenden e prokurimit, e qe esht shenjezimi i rrugeve, i cili rrit sigurin ne komunikacion dhe i cili mungon ne keto rrug tash 3 vite.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 7 të LPP të amandamentuar dhe at Piken 1-2-4, me rastin e anulimit të tenderit duke na diskriminuar si kompani e shpallur fituese ne Lot 2 dhe Lot 3. Para eliminimit te kesaj here dhe duke par faktet se jemi i vetmi operator i pergjegjshem. Arsyetimi që AK ka përdorur për anulim të tenderit nuk është në përputhje me asnjë dispozitë të LPP-së dhe si veprim në këtë fazë të tenderit konsiderohet diskriminues dhe njehkosisht duke na etiketura gjithmon me ndonje fakt te shpifur nuk na traiton në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe nuk vepron në mënyrë transparente ndaj kompanisë tonë siq kerkohet ne ket nen (Neni 7 Pika 1 pastaj Pika 2 dhe pika 4). Meqë disa herë OSHP e kthen këtë lëndë në rivlerësim ku se fundi edhe përmes urdhëresës e detyron AK me respektua LPP-në (Vendimi i OSHP i fundit i dates 27.05,2020 me nr 148-165-168-172-179/20) dhe kërkesat e dosjes për vlerësimin e tenderëve e ku në asnjërin rast nuk kishte bërë vërejtje rreth Referencave tona. Ndersa AK tani me te vetmin qellim qe ta anuloj tenderin shpik fakte te pa verteta dhe na e mvesh faktet e operatorve tjere ekonomik. Me ket rast AK ben shkelje te urdhereses se fundit te OSHP. Pretendmi i AK se ne nuk kemi referenca te mjaftushme nuk qendron, pasi qe ne ne vetem nje referenc kemi mbi 2 milion pune te kryer te veprimtaris se njejt (shiko dosjen e tenderti referencat tona afersisht 4 milion euro fillojn Nga faqja 961 deri 1070) dhe vetem nga faqja 1054-1070 e ofertes sone ne kemi nje deshmi si kontraten e bashkponimit, Pastaj situacionin e puneve te kryera dhe referencen qe kemi kry pune me nje shum 2.832.616,20 euro (Deshmij nr 2 Referenca). Andaj

vetem kjo Deshmi do te kishte qen e mjaftushme per AK. Andaj duke mos u marr me fakte te qarta, AK bene shkelje te keti Neni.

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenin 38 pika 7 të LPP-se të amandamentuar i cili thot,citojm;KRPP është e autorizuar dhe k apërgjegjësinë që të zhvilloj dhe shpallë rregullat dhe procedurat e nevojshme që qeverisin dhënien dhe përdorimin e kontratave publike kornizë. Rregullat dhe procedurat e tilla do të (i)promovojnë konkurrencë për kontrata të tilla, (ii)të sigurojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë e procesit, (iii)të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji mbi koston ekonomike, efikasitetin si dhe parimin e mos-diskriminimit të përcaktuar në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji; dhe(iv)të jetë në pajtim me praktikat e mira të vendeve anëtare të BE-së. Andaj AK me veprimin e vet dhe per justifikim, tek rasti i jon (Deshmija 5) ka bere shkelje te ketij neni, pasi qe nuk esht ne kompetencen e AK-se per te percaktuar rregullat dhe procedurat, por kjo eshte krykput detyre dhe pergjegjesi e KRPP-se, e aq me pak 12/8 pas hapjes se ofertave. Pas Kerkeses per rishqyrti AK e permison gabimin e vet dhe njehkosisht e hjeke kete pike apo arsye te eleminimit te tenderit mirpo edhe kjo na jep te kuptojm se ne AK ka pas vetem nje qellim nga fillimi pa marr parasysh faktet dhe deshmit arsyja ka qen dhe eshte vetem eliminimi i jon si OE i Pergjegjshem.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin 56 ku sipas tij AK së pari duhet të vlerësoj OE sipas plotësuesmërisë së kritereve kualifikuese e më pas sipas kriterit të vlerësimin që lidhet e nenin 56 të LPP. Po ashtu Nuk lejohet të aplikohen kritere që nuk kanë qenë të përfshira në Dosjen e tenderit. Me rastin e eliminimit të kompanisë tonë, shihet se AK nuk ka respektuar në asnjë pikë të nenin 56 te LPP-së e me se paku piken1-2 te ketij neni, i cili thot citojm: 1.1së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji. Dhe me vet faktin qe tani AK shpik fakte te pa verteta kinse ne nuk kemi referenca, ben shkelje te keti ligji njehkosisht edhe te Nenit 60 te keti ligji i cili po ashtu ne menyr te qart thot se, citojm: Nenin 60

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

   1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

   1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji.

Ktu AK me shpikje te ndryshme dhe pa marr parasysh faktet qe ne prezentojm ne ankesen per rishqyrtim eliminon tenderin ku ben shkelje te keti ligji.

Pretendimi 6: AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së(sidomos piken 1) ku sipas këtij neni si tenderues të përgjegjshëm konsiderohen vetëm OE që i plotësojnë kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Arsyt e shkeljes se keti neni sipas pikes 1 eshte sepse Komisioni i vlersimit se bashku me ZP nuk marrin fare parasysh faktet te cilat jan ne DT dhe te cilat ne po ashtu i prezentojm ne rastin e parashtrimit te ankese per rishqyrtim njehkosisht duke mos u marr me faktet tona kan ber edhe shkelje te Legjislacionit sekondar D01 dhe deklarates Nen BETIM. Në rastin konkret ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit ndërsa edhe përkundër kësaj AK na eliminon nga konkurrenca duke na cilësuar si të papërgjegjshëm dhe tenderin e anulon për arsye që aspak nuk qëndrojnë. Se AK ben shkelje te ketij neni e deshmojm me Deshmin

Nr 1 te cilat deshmi AK shum leht do te kishte verifikuar ne qoft se do te kishte deshire. Krejt ky veprim e shtyn AK-në drejt shkelës ë nenit 59 të LPP-së.

Pretendimi 7: AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së duke e anuluar tenderin kinse nuk ka operator te pergjegjshem. AK ben shkelje te keti neni se pari me manipulime na shpall te pa pergjejgshem, pastaj si merr fare parasysh faktet qe ne i prezentojm ne Kerkesen tone Per rishqyrtim. Neni 62 i lejon vetëm dy raste kur AK mundet të anuloj tenderin pas hapjes publike. Arsyetimi i AK nuk i përgjigjet rasteve që i lejon LPP dhe RRUOPP andaj edhe konsiderojmë se ka aplikuar gabimisht këtë mundësi.. Pra po shihet qartë se arsyetimet e tilla po përdoren vetëm si shkas dhe se veprimet janë komplet në kundërshtim me LPP-në për trajtimin e barabartë të 1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji. 13/8 OE. Shihet qartë se aplikimi i arsyeshmërisë për anulim tenderi është shumë tendencioz dhe i orkestruar ekskluzivisht kundër kompanisë tonë andaj si i tillë përpos që bie ndesh me nenin 62 të LPP-së, bie ndesh edhe me nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 8: AK shkelë edhe nenin 44 të RRUOPP-së me rastin e anulimit të tenderit sepse arsyetimi që AK ka përdorur për këtë qëllim (Kinse ne nuk kemi Referenca te mjaftushme) nuk qendrojn. Pas hapjes publike janë disa raste që AK mundet me i shfrytëzua për këtë qellim por në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjëri nga keto. Pasi qe pretendimi i AK se kinse nuk ka tenderues te pergjegjshem nuk esht i vertet dhe nuk paraqet faktet faktike te cilat ndodhen ne dosjen e ofertes te konzorciumit ton. Pasi qe ne disponojm referenca te mjaftushme (e qe esht mbi 4 milion euro dhe krejt kto te veprimtaris se njejt) dhe kto referenca kontrat pune pastaj pranimet teknike te puneve te gjitha jane ne dosje te ofertes, te cilat AK shum leht ka mund ti verifikoj. Mirpo ketu vrehet qellimi i AK, qe as pas kerkeses per rishqyrtim se merr fare mundin te na pergjigjet ne pretendimet tona dhe njehkosish ti verifikoj peretendimet tona ankimore ne kerkesen per rishqyrtim. Çështja e referencave tona nuk ka paraqitur problem ne vlersimin e pare dhe ne rivlersimet e me parshme per kete procedure te aktivtetit te prokurimit, andaj është e dyshimtë se si lindi kjo si problem mu ne momentin kur ne u shpallëm fitues në dy lot-e siq ka qen rasti me heren e kaluar, kur pikerisht kur ne jemi shpallur fitues te ketyre dy llotove nga komisioni i vlersimit. Kjo është edhe shumë jo etike dhe jo efektive kur AK-së i bie ndërmend që pas tri viteve procedura rreth mundimit për përzgjedhje të fituesit të anuloj atë me fakte te fabrikuara nga AK dhe me te pa verteta. Kjo përpos që është në kundërshtim me nenin 44 të RRUOPP-së, është edhe në kundërshtim me nenin 6 të LPP, sepse ky AK bënë shfrytëzim shume jo efektiv dhe jo efikas të buxhetit të paraparë për këtë qëllim. Sipas nenit 44 të RRUOPP-së AK mundet që vetëm në rastet e tilla të anuloj tenderin pas hapjes publike: 44. Ndërprerja e procedurave të prokurimit ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm Edhe kriteret tjera për të cilat AK mundet të anuloj tenderin, në rastin konkret nuk janë plotësuar fare, andaj me plot të drejt konstatojmë se AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 44 të RRUOPP. Kjo është shumë diskriminuese për kompaninë tonë dhe se aplikimi i këtij kriteri tashm është krejtësisht i pakuptimtë dhe tendencioz. AK me këtë veprim përpos që po shkel nenin 44 të RRUOPP-së, ai po shkelë plotësisht edhe nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 9: AK apo zyrtarret e komisionit te vlersimit se bashku me ZK ka shkel D01- Kodi Etik i Prokurimit e cila permban "Deklarata nën betim për Zyrtarët e Prokurimit", "Deklarata nën betim për anëtarët e komisionit për vlerësimin e tenderëve" e cila ne menyr te kjart thot se: 3.4 Objektiviteti- Personat e nderlidhur duhet të shfaqin nivelin më të lartë të profesionalizmit gjatë mbledhjes, vlerësimit, dhe

komunikimit te informacionit rreth aktivitetit të prokurimit ose procesit te vleresimit. Andja duke mos mbledhur faktet apo duke mos qen objektiv dhe duke mos u marr fare me faktet tona behet shkelje e keti ligji

Pretendimi 10: AK ka shkel edhe nenini 108/A te LPP-së Nr. 04/L-042 I amandatuar, pasi qe ne ankesen per rishqyrtim AK fare nuk merret me pretendimin ton per te cilin edhe shpallemi te papergjejgshem dhe fare nuk jep arsytime ne pretendimet tona, me ket rast AK shkelje te plot te keti ligji e posaqërishte pikes 12 te keti Ligji i cili thot citojm: Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Andaj AK duke mos arsytuar fare pretendimet dhe deshmit tona 14/8 ne kerkesen per rishqyrtim drejtuar AK sa i perket Referencave tona, ben shkelje te keti ligji duke mos na dhene fare sqarim ne keto pretendime (Pasiqe nuk merret fare me kto pretendime).

Bazuar në krejt çka kemi thënë më lartë kërkojmë nga AK, që pas shqyrtimit të ankesës tonë dhe marrjes për bazëtë fakteve të përmenduranga ne, të merr:

VENDIM

APROVOHETsi e bazuar Ankesa e Grupi i OE "Sinjal RKS-SHPK(Riemëruar TSR SHPK) & IDK Konstruksion & 2T"lidhur me tenderin "Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës (për Lot 2 dhe për Lot 3)" i iniciuar nga MINISTRIA E INFRASTRUKTURES,

TË ANULOHET vendimi i AK - MINISTRIA E INFRASTRUKTURES për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit e që realisht më pas do duhej që Fituespër këto lot-e të shpallej Grupi i OE **"Sinjal RKS-SHPK(Riemëruar TSR SHPK) & IDK Konstruksion & 2T".**

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "RSM COMPANY"SHPK - PRISHTINË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

1 Neni 59- Ekzaminimi,Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 105 – Kompetencat e OSHP-së

Autoriteti Kontraktues ka bere vlersim te gabuar dhe ne kundershtim me kete nen,duke ardhur ne perfundim se oferta jone është e papërgjegjshme ne aspektin teknik dhe profesional.

Në dokumentacionin teknik dhe profesional të paraqitur nga ana jone,ne kemi dorezuar të gjitha dokumentet ne perputhje me kriteret e dosjes se tenderit,ku per secilin lot qe kemi dorezuar oferte,ne kemi paraqitur stafin dhe makinerite e kerkuara ne perputhje te plote me kerkesat e Dosjes se tenderit.

Ne kete aktivitet te prokurimit kemi ofertuar ne 8 lote ku kemi paraqitur 9 Inxhinier të Komunikacionit,8 Inxhinier të Ndertimit dhe 1 inxhinier të Elektroteknikes,te gjithe të kompletuar me dokumentacionin e kerkuar,dhe jemi shperblyer me kontrate vetem ne lotin 5.

Poashtu ne kemi paraqitur te gjitha makinerite e kerkuara sipas kerkesave te DT-se dhe ne disa pozicione kemi paraqitur edhe me teper,kurse AK-ja ne vendimet e fundit na njofton se nuk permbushim kriteret minimale per tu shperblyer se paku edhe me 1 lot.
Vlen te theksohet se per Lot 2.ka pasur pretendime per eleminim per inxhinierin e permedur z.Sefedin Shala-Ing i Ndertimit,per te cilin OSHP-ja me vendimin P.SH,159,169,173/18 të datës 05.06.2018 (faqe 15) ka hudhe poshte kete arsye te eleminimit.

Është mjaft e quditshme se ne Vendimin mbi refuzimin e abkeses tone,pas atakimit te kesaj pike te eleminimit,dhe paraqitjes se provave dhe fakteve tona nuk permendet fare kjo pike dhe eshte hequr komplet nga vendimi ne fjale,duke patur parasysh se pikerisht per kete udheheqsja e Prokurimit te MI-se ka bere kerkese tek OSHP,per diskualifikim te RSM Company.
Poashtu ne Vendimin e AK-se,jemi njoftuar se kemi vendosur çmime manipulative ne lotet 2 dhe 3,kurse vete AK-ja na ka leshuar Referncat per 2 vite te perfunduara me sukses sipas kontrates per Lotin 5,ne te cilin kemi çmime pothuajse te ngjashme me lotot 2 dhe 3, qe tregon se ne kemi kryer 2 vitet dhe vazhdojme te kryejme edhe vititn e fundit te kontrates,ne perputhje te plote me kushtet e kontrates dhe urdheresave te menaxherit.

Bashkanjgitur referencat e leshuara nga Ministria e InfrastrukturesperLot 5

Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Autoriteti Kontraktues per here te trete,po tenton te anuloj padrejtesisht kete aktivitet te prokurimit me arsyetimet me banale te mundshme dhe ne kunderstim te plote me Ligjin e Prokurimit dhe njëkohësisht me Vendimet e OSHP-se,pasi ne vendimet paraprake jemi shpallur te pergjegjshem ne kete aktivitet te prokurimit,perkunder pretendimeve te vazhdueshme nga ana e AK-se dhe operatoreve tjere ekonomik.

Neni 105 - Kompetencat e OSHP-së

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me vendimet paraprake ne OSHP-se,konkretisht me vendimin P.SH. 159,169,173/18 të datës 05.06.2018 dhe vendimit P.SH.181,182,191/19 të datës 19.06.2019,ku në këto vendime Paneli Shqyrtues konstaton se kompania RSM Company shpk,është e përgjegjshme dhe plotëson të gjitha kriteret e Dosjes së Tenderit ,andaj keto arsyetime te AK-së për eleminimin jane situate e RES JUDICIATA,pra jane pretendime te gjykuara me heret nga ana e OSHP-se.

I PROPOZOJME OSHP-së:

-Që të korrigjoj shkeljet e vërtetuara si më lartë,të parandaloj dëmtimin e mëtejmë të parasshtruesit të ankesës, dhe të merr vendim për rivlerësim,për shkak se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është në kundërshtim të plotë me LPP-në.
Ne si OE mbesim mesim me shprese që OSHP-ja, ankesen tone ta vlersoj drejt dhe ti parandaloj padrejtesite dhe humbjet ne aspektin financiar që na shkaktohen,të anuloj vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimti dhe të kthej në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit për lotet 2 dhe 3

KRITERET PËR VLERËSIM

-Neni 61 i LPP-së-Tenderët Jo Normalisht të Ulët

-Neni 62 i LPP-së-Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Rregullorja dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, paragrafit 18.3

Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 3, për Llot I-VII, dhe Llot VIII: Lista e kontratave te realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Ndriqim rrugor, Semafor, Numrues te Trafikut).

Dëshmia 3, për Llot I-VII, dhe Llot VIII: Lista e kontratave te realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Mirëmbajtja e Ndriqimit rrugor, Mirëmbajtja e Semaforeve, Mirëmbajtja e Numruesve te Trafikut)

Kërkesa 4: Mesatarja e të punësuarve (që janë në listën e pagave) në tri vitet e fundit duhet të jetë min. 10 të punësuar. Nëse oferta përfshin me shume se një LOT (Pjesë), numri i personelit duhet te rritet ne varësi te numrit te lloteve për të cilat oferton.

Dëshmia 4: Mesatarja e të punësuarve (që janë në listën e pagave) në tri vitet e fundit duhet të jetë min. 10 të punësuar. Nëse oferta përfshin me shume se një LOT (Pjesë), numri i personelit duhet te rritet ne varësi te numrit te lloteve për të cilat oferton

Kërkesa 5: Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar ose origjinal. OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisjen) për pajisjet, të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen nga noteri sipas procedurës se verifikimit të pajisjeve).

Evidenca 5: Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar ose origjinal. OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisjen) për pajisjet, të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen nga noteri sipas procedurës se verifikimit të pajisjeve).

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 2: Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompanija në bankë në vlerë prej së paku 100,000.00 €, ose qasje ne kredi nga një bankë).

Evidenca 2: Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose çasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit, komisioni rivlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni për rivlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në raportin e tyre me datë 31.08.2020 rekomandojnë që aktiviteti i prokurimit të anulohet me arsyetimin se asnjëri nga tenderuesit nuk i plotëson kriteret e kërkuara duke i shpallur të gjithë OE pjesëmarrës të papërgjegjshëm.

AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eleminuar për të gjithë OE pjesëmarrës në këtë tender sqaron se Vlerësimi i ofertës është bërë duke u bazuar në dosjen ë tenderit,jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit.Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë,ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë,mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëhere.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "I.T.K" SHPK-PEJË

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues "I.T.K"Shpk se AK gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se numri mesatar i te punësuarve në tri vitet e fundit(2015,2016 dhe 2017) nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit,përkatësisht në Njoftimin për Informata Shtesë ose përmirësim gabimi tek kërkesa 4 është kërkuar që Mesatarja e të punësuarve (që janë në listën e pagave) në tri vitet e fundit duhet të jetë min.10 të punësuar.Nëse oferta përfshin me shume se një LOT (Pjesë), numri i personelit duhet te rritet në varësi te numrit te lloteve për të cilat oferton.

OE "I.T.K"Shpk në ofertën e tij ka prezentuar numrin e stafit 32 për vitin 2017,për vitin 2016 ka prezentuar numrin e stafit 22 dhe për vitin 2015 numrin prej 26.
Eksperti shqyrtues konstaton se bazuar në vendimin e AK, sipas të cilit OE ankues është shpërblyer me tri lote në këtë aktivitet të prokurimit,numri i stafit të prezentuar nga OE ankues nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit për kapacitet teknik dhe profesional sepse në asnjërin për vitet e lartëcekura ky OE nuk ka prezentuar staf me shume se 40 punëtore,andaj ky pretendim është i pa qendrueshëm.
Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr 455-464/18 të datës 05.10.2018.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me vendimin e Autoritetit Kontraktues se OE ankues I.T.K"Shpk nuk e plotëson kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional për pajisjet e kërkuara ku sipas këtij vendimi të AK-së,OE ankues ka ofertuar në 6 lote, mirëpo pajisjet i ka ofruar vetëm për tri llote dhe sipas AK-së,ky OE është shpërblyer me kontratë për tri llote në këtë aktivitet të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr 455-464/18 të datës 05.10.2018.
OE ankues I.T.K"Shpk në ankesën e tij nuk ka dhënë ndonjë arsyetim lidhur me pajisjet e ofruara apo edhe kundërshtimet me arsyet e eleminimit të ofertës së tyre nga ana e AK-së por vetem ka bërë një përshkrim të kronologjisë së këtij aktiviteti të prokurimit duke theksuar se oferta e tyre është më e lirë.Konisderoj që ky pretendim është i gjykuar në vendimin e OSHP-së dhe është i pa bazuar.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OE ANKUES "DOREARTI"SHPK. ;"BENI COM" SHPK;"LINDI MARKINGS"SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE"Dorearti"Shpk;"Beni com"Shpk ; "Lindi Markings"Shpk,se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën e kapacitetit ekonomik dhe financiar të dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ketë kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompanija në bankë në vlerë prej së paku 100,000.00 €, ose qasje në kredi nga një bankë), e dëshmuar me deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose çasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar.
Grupi i OE"Dorearti"Shpk;"Beni com"Shpk ; "Lindi Markings"Shpk ka dorëzuar një Letër Referencë të ProCredit Bank duke specifikuar se ProCredit Bank do të konsideroj mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetin e tij finanaciar dhe nëse plotësohen kushtet e përcaktuara nga Banka për financimin ne fjalë.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019,citoj një pjesë të vendimit"Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton lidhur me letër përkrahjen nga bankat për OE në fjalë se në lëndën e AK gjenden shkresat e lëshuara nga Procredit Bank me datën 11.06.2018,në të cilat dëshmohet gjendja e llogarisë bankare e OE "Dorearti" në vlerë mbi 100,000.00 € (mbi Njëqindmijë euro),të cilat shkresa grupi i OE ankues i ka dorëzuar në AK,pas kërkesës së AK që grupi i OE ankues konform nenit 72 të LPP-së,të dorëzoj dëshmi shtesë për ta sqaruar përkrahjen nga banka lidhur mjetet e gatshme në vlerë prej 100,000.00 €.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e grupit të OE"Dorearti"Shpk;"Beni com"Shpk ; "Lindi Markings"Shpk,se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën 3. të kapacitetit teknik dhe profesional,ku është kërkuar lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500,00.00 € në tri vitet e fundit të lëmisë së kërkuar që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e prezentuara e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019,citoj një pjesë të vendimit"Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se pretendimi i lartëpërmendur është i bazuar për faktin se grupi i OE ankues se bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar lista të projekteve të realizuara të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014,2015 dhe 2016) të shoqëruara me kontrata dhe referenca/raporte të pranimit teknik konform kërkesës

dhe dëshmisë së parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si vijon : lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Mirëmbajtja e Ndriqimit rrugor, Mirëmbajtja e Semaforeve, Mirëmbajtja e Numruesve te Trafikut).

Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është gjykuar më parë nga OSHP dhe pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se AK ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se pajisjet e ofruara nuk janë konform kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional dhe specifikimit teknik në dosje të tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar ose origjinal. OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisjen) për pajisjet, të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen nga noteri sipas procedurës se verifikimit të pajisjeve).

Grupi i OE"Dorearti"Shpk;"Beni com"Shpk ; "Lindi Markings"Shpk ka dorëzuar një raport për mjetet,stabilimentet dhe pajisjet teknike,dy çertifikata të regjistrimit të automjetit dhe një dokument unik doganor me nr IE0283639D për pajisjen makinë për shënimin e vijave në asfalt.
Dokumenti unik doganor është në emër të N.P.T "Noli" Xërxë,Rahovec dhe OE ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që kjo pajisje është në pronësi të saj apo ndonjë dëshmi të blerjes apo marrjeës me qira siç është kërkuar në dosje të tenderit.Gjithsesi AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj sqarime apo dokumente shtesë nga OE për këtë pajisje.

Oferta e grupit të OE"Dorearti"Shpk;"Beni com"Shpk ; "Lindi Markings"Shpk AK nga është shpallur e përgjegjshme përfshirë këtu edhe çështjen e pajisjeve por është vlerësuar si ofertë më e shtrenjtë dhe nuk është rekomanduar për kontratë siç është rasti i vendimit të AK nr. ZP 36/2018 të datës 02.07.2018

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimin e grupit të OE"Dorearti"Shpk;"Beni com"Shpk ; "Lindi Markings"Shpk- se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020,AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuara janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eleminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit,jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit.Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë,ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë,mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëhere.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë,ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017,04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes "Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54" ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit),andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP,sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente,duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit"

Konsideroj qe pretendimi ankimor është i bazuar

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "SELECT PRIMA"SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE "Select Prima"Shpk,se AK gjatë rivleërsimit pa të drejte ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se ka ofruar çmime me më shume se dy numra pas presjes dhjetore që konform Rregullorës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, paragrafit 18.3,çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje te vlerës se ofertës dhe rrjedhimisht çmimet e ofruara janë me vlerë 0.00,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

AK duke u thirrur në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik,paragrafi 41.15 me datë 21.08.2020 përmes Letrës Standarde për sqarimin e tenderit ka kërkuar nga OE "Select Prima"Shpk të shpejgoj çmimet e ofruara me 0.00 €.
Me datë 21.08.2020 OE "Select Prima"Shpk ka sqaruar se nuk kanë ofruar çmime me 0.00 €,por kanë ofruar çmim me 0.001 €,ndërsa referimi i AK-së për nenin 41.15 të RROPP-së për OE ankues nuk është i saktë dhe nuk ka të bëjë me këtë rast.

Eksperti shqyrtues konstaton se arsyetimi i OE ankues "Select Prima"Shpk është i bazuar ngase ky OE nuk ka ofruar çmim me vlerë prej 0.00,ndërsa neni 41.15 i RRUOPP-së ndërlidhet me rastet kur ofrohet çmimi prej 0.00 €.

Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e grupit të OE Select Prima"Shpk,se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020,AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuara janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eleminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit,jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit.Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë,ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë,mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëhere.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë,ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017,04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes "Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54" ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit),andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP,sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente,duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit"

Konsideroj qe pretendimi ankimor është i bazuar

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "RSM COMPANY"SHPKPërgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE "RSM Company"Shpk,se AK gjatë rivlerësimit ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi për pajisjen nr 2 konform kërkesës së dosjes së tenderi,eksperti shqyrtues se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-se,PSH.nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se në ofertën e OE ankues "RSM COMPANY"SHPK gjenden listat e pajisjeve për secilin Lot veç e veç ku vlen të ceket se këto lista kanë përshkrim të njejte për llojin e pajisjes për LOT 1deri ne LOT 6.Poashtu ketyre listave i janë bashkangjitur kopjet e dokumenteve të pajisjeve të vërtetuara tek noteri z.Zylefer Aliu.Andaj autoriteti kontraktues me të njejtat dokumente ka shpallur fitues OE në fjalë për LOT 5,ndërsa për LOT 2 dhe 3 e eleminon nga ky aktivitet i prokurimit përkundër që në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit janë parashtruar kërkesat dhe dëshmitë e njejta si për LOT 5 ashtu edhe për LOT 2 dhe 3,me çka nënkuptohet se autoroieti kontraktues nuk e ka trajtuar barabartë ofertën e OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit për LOT-et veç e veç.

Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është trajtuar dhe pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE "RSM Company"Shpk se oferta e tyre është eleminuar me arsyetimin se nuk ka ofruar një deklaratë me shkrim e cila do të përfshinte një zbërthim të pjesëve relevante të tenderit konform nenit 61 të LPP-së Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe Rregullat për tenderët Jo-Normalisht të Ulët,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Me datë 21.08.2020,AK përmes Letrës standarde për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët ka kërkuar nga OE "RSM Company"Shpk që të jep një shpjegim detal të elementeve përbërese të tenderit lidhur me disa çmime të cilat nuk korrespondojne më çmimet e tregut.

Me datë 30.09.2020,eksperti shqyrtues përmes e-mailit ka kërkuar nga OE "RSM Company"Shpk nëse i është përgjigjur kërkesës së AK-së për sqarime të elementeve të tenderit.
Në të njejtën datë nga OE "RSM Company"Shpk kam pranuar sqarime se me datë 24.08.2020 kanë dërguar tek zyrtari i AK-së dokumentin me sqarime për elemenetet e tenderit.
OE "RSM Company"Shpk në dokumentin e dërguar ka sqaruar për të gjitha pozicionet e kërkuara duke kalkuluar kostot për secilin pozicion/element të tenderit duke ja bashkangjitur dhe faturat e furnizuesve dhe dudat doganore të materialeve.
Për ekspertin shqyrtues është i paqartë arsyetimi i AK-së se OE nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës apo cila nga sqarimet është në kundërshtim më kërkesën e AK-së.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Sa i përket pretendimit tjetër se dosja për Inxhinierin e Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv z Sefedin Shala nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues së ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.15-169-173/18 të datës 05.06.2018 në të cilin pretendimi ankimor i OE ankues është gjykuar si i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "RSM Company"Shpk,se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020,AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuara janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eleminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit,jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit.Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë,ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë,mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëhere.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë,ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017,04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes "Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54" ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit),andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP,sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente,duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit"

Konsideroj qe pretendimi ankimor është i bazuar

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OE ANKUES "TSR"SHPK;"IDK KONSTRUKSION" ;"2T"

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE TSR"Shpk &"IDK Konstruksion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk),se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën 3. të kapacitetit teknik dhe profesional,ku është kërkuar lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500,00.00 € në tri vitet e fundit të lëmisë së kërkuar që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e prezentuara e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të dorëzojne listën e kontratave të realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Mirëmbajtja e Ndriqimit rrugor, Mirëmbajtja e Semaforeve, Mirëmbajtja e Numruesve te Trafikut)

Grupi i OE TSR"Shpk &"IDK Konstruksion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk) se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listat e kontratave për dy anëtarët e konzorciumit,eksperti shqyrtues më poshtë po e liston vetëm një kontrat e cila e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit.
-Kontrata në mes të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe OE "IDK Konstruksion",e lidhur me datë 31.12.2014 për "Përmirësimin e sigurisë dhe i sinjalistikës rrugore në superstraden Tiranë-Durrës dhe segmentin rrugor Kashar-Rinas Loti 2 " në vlerë prej 295,101,639.00 lekë apo 2,459,180,325.00 €.
Gjithashtu është i bashkangjitur edhe Raporti i pranimit sipas të cilit punimet janë realizuar në shumë prej 295,097,534.00 lekë me datë 03.09.2015.
Nga kjo shumë OE "IDK Konstruksion ka kryer 60% të punimve të kontratës ndërsa nënkontraktori "Madenkost"Shpk ka realizuar 40% të kontratës.

Eksperti shqyrtues konstaton se kjo kontratë është konform kërksës së dosjes së tenderit dhe përmbush vlerën e kërkuar prej 500,000.00 €.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e grupit të OE TSR"Shpk &"IDK Konstruksion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk),se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020,AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuara janë të papërgjegjshme duke sqaruar në

letrat standarde për tenderuesit e eleminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit,jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit.Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë,ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë,mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëhere.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë,ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017,04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes "Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54" ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit),andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP,sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente,duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit"

Konsideroj qe pretendimi ankimor është i bazuar

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë ekzaminimin,vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së dhe vendimeve dhe urdherësave të OSHP-së,andaj rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të **aprovohen pjesërisht si të bazuara**,të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS"
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - "I.T.K" SHPK
- OE ankues - "DOREARTI"SHPK
- OE ankues - "SELECT PRIMA"SHPK
- OE ankues - "RSM COMPANY"SHPK
- OE ankues - "TSR"SHPK (ISH SINJAL SHPK)